



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

**AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL**

**Tiranë, Prill 2018**

## RAPORT

### Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC)

#### Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me vendimin nr. 202, datë 04.10.2017 “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, ka vendosur kryerjen e mbikëqyrjes tematike në këtë institucion.

Vendimi i përfshirjes së këtij institucioni në procesin e mbikëqyrjes, është marrë nga Komisioneri, për shkak të informacioneve të ardhura nga nëpunës civilë të AAC, ku janë pretenduar parregullsi në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, pas fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes, me nr. 252/5 prot., datë 04.10.2017, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 252/6 prot., datë 04.10.2017 “Njoftim në lidhje me mbikëqyrjen në Institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, i është njoftuar institucionit.

Në përmbajtjen e ligjit të posaçëm, në bazë të të cilit funksiononte AAC, deri në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk parashikohej ndonjë procedurë pranimi konkurruese për punonjësit e punësuar në administratën e këtij institucioni. Në këto kushte, mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, zhvillimi i karrierës, garantimi i të drejtave dhe përcaktimi i detyrimeve për punonjësit e administratës së AAC, janë rregulluar me ligjin nr. 7661, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me përfshirjen e administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil në shërbimin civil, në referencë të neneve 4/1, germa “a”, “f” dhe 20, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, emërimi i nëpunësve civilë në administratën e AAC, tashmë nuk është kompetencë e Drejtorit Ekzekutiv, për arsye se në administratën shtetërore, emërimet në shërbimin civil realizohen nga njësia përgjegjëse (DAP), nëpërmjet një procedure konkurrimi të hapur, për nivelin ekzekutiv, ose nëpërmjet zhvillimit të sistemit të karrierës, për nivelin e ulët, të mesëm dhe të lartë drejtues, në shërbimin civil.

Ligji nr. 168/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, ka sjellë në koherencë rregullimin e marrëdhënieve të punës së burimeve njerëzore, me ligjin për shërbimin civil, pasi në këtë ligj, është përcaktuar në

mënyrë të shprehur se, “*Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e autoritetit rregullohen me legjislacionin e shërbimit civil*” (neni 8, pika 2 e ligjit).

Në momentin e fillimit të mbikëqyrjes pranë institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, u konstatua se ndryshimet ligjore, që në këtë rast përfshijnë edhe kompetencat e titullarit, nuk janë zbatuar në disa institute të ligjit për nëpunësin civil dhe parregullsitë e konstatuara do të shtjellohen në vijim të materialit.

Ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përfshin për herë të parë në shërbimin civil Administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil, si institucion në varësi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (aktualisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë), çka materializohet edhe në “*Listën e institucioneve të administratës shtetërore*”, që hyjnë në fushën e shërbimit civil, i parashikuar në lidhjen nr. 1 (me numër rendor 28), që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, i cili është trajtuar së bashku me institutet e tjera të ligjit të lidhura me të, ndër të cilat në lidhje me respektimin e kërkesave për pranimin në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Zamira Mujali dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projekt raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Me shkresën nr. 299 prot., datë 28.02.2018 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Pas kësaj, me shkresën nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018, të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, “Kthim përgjigje”, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me observacionin përkatës, i cili është analizuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit paralajmërues për miratimin e tij, i cili përcakton edhe detyrat për të rregulluar situatën e konstatuar.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit AAC, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Departamentit të Administratës Publike, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Grupi i mbikëqyrjes, verifikoi dosjen individuale për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil si dhe çdo dokument tjetër lidhur me çështje të personelit që rregullohen shprehimisht nga ligji për nëpunësin civil. Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me znj. Lilika Radovicka, Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, gjatë të cilit u prezantua objekti dhe drejtimet e mbikëqyrjes, si dhe dokumentacioni shkresor që do të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes. Nëpunësja Eva Depa, me detyrë “*Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore*”, u caktua si person kontakti me grupin e punës.
- Grupi i punës shqyrtoi dhe analizoi pozicionet e punës në shërbimin civil, sipas strukturës dhe organikës analitike të institucionit.
- Verifikoi përmbajtjen e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- Kontrollon të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, (*nivelin e diplomës së arsimit të lartë, profilin e arsimit të lartë, etj.*), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil, i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- U verifikuan dhe administruan materialet që pasqyrojnë plotësimin e vendeve të lira sipas procedurave që janë aplikuar për plotësimin e tyre, ku përfshihen aktet e emërimit në pozicionet përkatëse, si nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete, të cilët janë të organizuar në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

### **Përmbajtja e Projektraportit:**

#### **I. Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil në administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC).**

Autoriteti i Aviacionit Civil, është një institucion që ka funksionuar sipas ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" dhe ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar. Sipas këtyre akteve ligjore, Këshilli Drejtues ka qenë autoriteti që, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, ka miratuar kriteret që do të zbatoheshin për punësimin e personelit të Autoritetit.

Më konkretisht, në nenin nr. 12, të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv, në shkronjën "dh", ishte përcaktuar se, **Drejtori Ekzekutiv** "emëron personelin e nevojshëm sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe administron burimet njerëzore...", e cila nuk pasqyronte ndryshimet në administrimin e burimeve njerëzore, pas përfshirjes së institucionit në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, grupi i mbikëqyrjes konstaton se, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (në datën 26.02.2014), administrata e Autoritetit të Aviacionit Civil, funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës së miratuar me vendimin nr. 791, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të organikës, si dhe të nivelit të pagave të administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil".

Bazuar në këtë strukturë organizative, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (në datë 26.02.2014), në administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil kanë qenë gjithsej **66** vende pune, nga të cilat:

- **1 pozicion pune është funksion i emëruar (Drejtori Ekzekutiv).**
- **61 pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil** nga të cilët:
  - ✓ 7 pozicione në nivelin e mesëm drejtues, me emërtesën "Drejtor Drejtorie";
  - ✓ 10 pozicione në nivelin e ulët drejtues, me emërtesën "përgjegjës sektori";
  - ✓ 44 pozicione në nivelin ekzekutiv, me emërtesën "specialist/inspektor".
- **4 pozicione pune kryejnë funksione administrative (3 shofer + 1 punonjës pastrimi).**

Më pas, për shkak të ndryshimeve ligjore të ardhura si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit për shërbimin civil, është miratuar vendimi nr. 100, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 791, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të organikës, si dhe të nivelit të pagave të administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil", i cili ka hyrë në fuqi (pas botimit në fletoren zyrtare nr. 28/2014) në datën 11.03.2014. Me anë të këtij vendimi është miratuar struktura, organika, niveli i pagave dhe numri i përgjithshëm i punonjësve për

institucionin, sipas të cilës ishte parashikuar shtimi me 2 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në nivelin e ulët drejtues (*përgjegjës sektori*).

Kjo strukturë, më tej i është nënshtruar disa ndryshimeve, të cilat, mbështetur në pikën 1, të nenit 8, të ligjit nr. 168/2014 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”*”, janë miratuar nga ministri përkatës. Konstatohet se në këtë rast, ky veprim nuk është konsultuar me ministrin përgjegjës për administratën publike, ashtu si e përcakton ky ligj, në nenin 8, pika 1 e tij.

Konkretisht, ndryshimet në strukturë paraqiten në këtë mënyrë:

a) Me vendimin nr. 60, datë 21.11.2016, të Këshillit Drejtues, miratuar me shkresën nr. 5760/3 prot., datë 30.12.2016 “*Mbi ndryshimet në strukturën e Autoritetit të Aviacionit Civil*”, të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, janë përcjellë shtesat në organikë:

- ✓ Kabineti i Drejtorit Ekzekutiv
  - Shef Kabineti;
  - Këshilltar (Asistent);
  - Sekretare Teknike;
- ✓ Shofer – nga 1 (një) pozicion behet 3 (tre);
- ✓ Pastrues – nga 1 (një) pozicion behet 2 (dy).

b) Me vendimin nr. 69, datë 12.04.2017, të Këshillit Drejtues, miratuar me shkresën nr. 5760/3 prot., datë 30.12.2016 “*Përcillet miratimi i ndryshimeve në strukturën e AAC*”, të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës, janë përcjellë shtesat: Në Sektorin e Informacionit shtohet:

- ✓ **1** (një) pozicion “*Specialist për marrëdhëniet me jashtë*”;
- ✓ Në Sektorin e Mbikëqyrjes Teknike shtohet **1** (një) pozicion “*Inspektor*”;
- ✓ Në Sektorin e Mbikëqyrjes së Masterplaneve, Mjedisit dhe Cilësisë shtohen **2** (dy) pozicione “*Inspektor*”;
- ✓ Në Sektorin e Certifikimit të Personelit të Sigurisë shtohen **2** (dy) pozicione “*Inspektor*”;
- ✓ Në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë në Aviacion shtohet **1** (një) pozicion “*Inspektor*”;
- ✓ Në Sektorin e Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit shtohen **2** (dy) pozicione “*Inspektor*”;
- ✓ Në Sektorin e Burimeve Njerëzore shtohet **1** (një) pozicion “*Specialist*”;
- ✓ Në Sektorin e Prokurimeve dhe Shërbimeve shtohet **1** (një) pozicion “*Specialist*”.

Pra, në strukturën organike aktuale të AAC, janë shtuar **17 pozicione të reja**, nga të cilat **11** pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.

Nga sa më sipër, struktura në administratën e Autoritetit të Aviacionit Civil, në momentin e mbikëqyrjes paraqitet me **83** pozicione pune gjithsej, nga të cilët, pozicione pjesë e shërbimit civil, janë **74** pozicione, të ndara në nivele sipas nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil, si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **9** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **11** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **54** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist/Inspektor*”

Nga analiza e pozicioneve në shërbimin civil, konstatohet se, struktura dhe organika e miratuar për institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, parashikon qartësisht hierarkinë e shërbimit civil. Në nenin 18, të ligjit nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”, përcaktohet se institucionet e varësisë drejtohen dhe përfaqësohen nga drejtori, në rastin konkret Drejtori Ekzekutiv, i cili raporton tek ministri përgjegjës. Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë e lartë drejtuese, të mesme drejtuese, të ulët drejtuese dhe ekzekutive, është parashikuar në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në mbështetje të kësaj dispozite, ka dalë vendimi nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, ku në pikën 5, të Kreut II, ka përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë.

Përgjegjësitë dhe detyrat kryesore mbi të cilat funksionon secili pozicion pune, janë përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil, miratuar me vendimin nr. 29, datë 21.4.2013 “*Rregullore e brendshme Autoritetit të Aviacionit Civil*” dhe aktualisht mungojnë përshkrimet e punës në këtë institucion. Në këto kushte, në rregullore nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë ndodhur në organizimin e institucionit të Autoritetit, e po kështu nuk është përshtatur, për të qenë në koherencë me ligjin për nëpunësin civil.

### **Konstatim:**

Në lidhje me organizimin e brendshëm të këtij institucioni, rezulton se, me vendimin nr. 343, datë 07.06.2006, të Këshillit të Ministrave “*Për Pronësinë dhe Administrimin e Aeroportit të Kukësit*”, është vendosur që Aeroporti i Kukësit të kalonte në administrimin dhe përgjegjësinë e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Në mbështetje të këtij vendimi, ka dalë urdhri nr. 2, datë 17.1.2007, i Ministrit të Financave “*Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007*” dhe udhëzimi nr. 5, datë 17.4.2007, i MF “*Për përdorimin e fondeve të investimeve buxhetore për konservimin e Aeroportit të Kukësit*”, sipas të cilave caktohet Drejtorja e Përgjithshme e Aviacionit Civil, për të përballuar shpenzimet e administrimit të aeroportit të Kukësit nga fondet e investimeve buxhetore të programuara për konservim, deri në vënien në punë të tij.

Nga ana tjetër, urdhri nr. 64, datë 27.4.2009 i MF “*Për një ndryshim në urdhrin e Ministrit nr. 3618/1, datë 25.06.2007 “Për administrimin e Aeroportit të Kukësit”, i ndryshuar*” thekson se “*Efektet financiare për pozicionet në stafin përbërës të Aeroportit të Kukësit, fillojnë në datën e*

*fillimit të punës të përcaktuar në kontratat individuale*”. Në të njëjtën linjë është edhe urdhri i brendshëm nr. 2, datë 05.01.2017, i Drejtorit ekzekutiv të AAC, dalë në zbatim të vendimit nr. 61, datë 21.11.2016 dhe vendimit nr. 63, datë 09.12.2016 “Për miratimin e programit ekonomik të AAC-së për vitin 2017”, të Këshillit Drejtues, sipas të cilit është ngarkuar Drejtoria e Shërbimeve për të ndjekur dhe zbatuar *kontratat individuale të punësimit* për këta punonjës.

Për sa parashtruar në këtë rast, mbështetur në këto akte nënligjore apo rregullative, mbi të cilat funksionon administrata e Aeroportit të Kukësit, të cilat parashikojnë marrëdhënien kontraktuale për punësimin e punonjësve të këtij aviacioni, ky institucion, aktualisht nuk është përfshirë në mbikëqyrje.

### **Konkluzion:**

Për sa analizuam në këtë rubrikë të raportit, arrijmë në konkluzionin se, në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrur, evidentohen pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, siç janë: funksionarët politikë dhe punonjësit administrativë.

Në kushtet kur Rregullorja e Brendshme e veprimtarisë së institucionit, është miratuar në vitin 2013 dhe për pasojë, në të nuk janë pasqyruar ndryshimet ligjore, si në drejtim të organizimit të brendshëm të institucionit me ligjin aktual, ashtu edhe në drejtim të përshtatjes së administrimit të burimeve njerëzore në koherencë me ligjin për shërbimin civil, me qëllim që të qartësohet roli dhe funksioni i çdo nëpunësi civil, institucioni i AAC nëpërmjet Këshillit Drejtues, në zbatim të shkronjës “c”, të nenit 6, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, të propozojë ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të veprimtarisë së institucionit.

Pas kësaj, në kushtet kur në këtë institucion mungojnë formularët e përshkrimit të punës, si një aspekt i rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, punonjësit e ngarkuar me hartimin e përshkrimeve të punës në institucion, sipas hierarkisë së përcaktuar ligjore, bazuar në rregulloren e veprimtarisë së institucionit dhe kërkesat e ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, me qëllim që të përcaktohen qartë detyrat, objektivat dhe kërkesat që duhet të plotësojë kandidati në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, duhet të fillojnë menjëherë procesin e hartimit të këtij formulari dhe miratimin e tij, sipas këtij rendi pune:

- ✓ Të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, dhe lidhjeve të cilat janë pjesë e këtij vendimi, si dhe udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike. Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e tyre, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe detyrimin për depozitimin pranë njësisë përgjegjëse.
- ✓ Drejtuesi i njësisë së burimeve njerëzore, në cilësinë e analistit të punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës, të mbledhë informacionin e nevojshëm



për çdo pozicion pune dhe pas një analize të këtij informacioni, të përcaktohen në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion apo grup pozicionesh të shërbimit civil.

- ✓ Formati i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil, të jetë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 1 datë 31.05.2017, të Departamentit të Administratës Publike dhe të ketë të përfshirë të gjithë elementet, siç janë të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.
- ✓ Në ndarjen “*Misioni*”, duhet të mbahet parasysh dhënia e përkufizimit të misionit të njësisë përkatëse. Duhet të jetë i qartë dallimi midis misionit të njësisë përbërëse dhe qëllimit të përgjithshëm të pozicionit të punës, kjo për faktin se “*Misioni*” identifikon një përshkrim të përgjithshëm, të përmbledhur të qëllimit për të cilin ekziston njësi përkatëse. Misioni i drejtorisë duhet të jetë i njëjtë për të gjitha pozicionet vartëse të saj duke përfshirë pozicionet “*përgjegjës sektori*” dhe “*specialist*”.
- ✓ Duke vazhduar më tej me “*Detyrat kryesore*”, të cilat përcaktojnë arsyen kryesore të ekzistencës së pozicionit të punës: përgjithësisht këto detyra marrin pjesën më të madhe (80%) të kohës së nëpunësit. Detyrat kryesore duhet të paraqiten si rezultat i punës së kryer. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh që të përdoret terminologjia e duhur dhe përdorimi i foljeve në vetën e tretë njëjës.
- ✓ Në ndarjen “*Kërkesat e posaçme*”, përcaktohen kërkesat specifike të vendit të punës lidhur me nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë, e përcaktuar kjo në terma kohorë dhe pozicion përkatës, si dhe njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen me sukses të funksionit të pozicionit të punës. “*Kërkesat e posaçme*” marrin një rëndësi të madhe në përcaktimin e saktë të tyre, pasi do të shërbejnë si kritere kryesore në procesin e rekrutimit dhe seleksionimit të kandidatëve për një pozicion të caktuar pune.  
Për këtë arsye duhet të plotësohet në mënyrë të qartë niveli i arsimit (*niveli i diplomës “Bachelor”, “Master Profesional”, “Master i Shkencave” që ai/ajo duhet të zotërojë*); Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
- ✓ Pas marrjes së konfirmimit nga njësi përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Linjës, në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave.
- ✓ Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

Në zbatim të detyrave ligjore, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike të drejtojë punën, për të siguruar efikasitetin e strukturës së institucionit për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me ligjin për shërbimin civil dhe detyrat ligjore të institucionit, si dhe për të finalizuar sa më parë procesin e përshkrimeve të punës në këtë institucion.

Duke u nisur nga paqartësia që konstatohet mbi organizimin dhe pozicionimin në lidhje me shërbimin civil të pozicioneve të punës në Aeroportin e Kukësit, si dhe në zbatim të nenit 7 (*shkronja “ç” e “gj”*), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, çmohet se Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me institucionin e AAC, duhet të përcaktojë qartë raportin që kanë pozicionet e punës në këtë Aeroport, me shërbimin civil.

***II. Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të gjendur në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014) dhe si janë zbatuar procedurat gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit.***

Ashtu si e kemi analizuar edhe më sipër, Administrata e AAC, është përfshirë për herë të parë në fushën e shërbimit civil, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në nenin 67, “*Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë*”, të këtij ligji, parashikohet rregullimi i statusit për nëpunësit dhe punonjësit, të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të tij, kryenin detyra në vende pune me statusin e shërbimit civil. Nga përmbajtja e dispozitës në fjalë, rezulton se Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur, e për këtë arsye, ky institucion ngarkohet me disa detyra dhe përgjegjësi specifike, të cilat evidentohen me hollësi edhe në aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit për nëpunësin civil.

Një nga detyrat që ligji i ngarkon njësisë përgjegjëse në momentin e implementimit të ligjit të ri për nëpunësin civil, është deklarimi i statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e fillimit të efekteve të tij, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*neni 67, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*).

Në këtë dispozitë dhe konkretisht në pikën 3, 4 dhe 6, të saj, përcaktohet shprehimisht:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 67 të ligjit, është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i cili në pikën 1, të Kreut III “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komunat”, përcakton se:

*“Punonjës ekzistues”, sipas pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, që kryejnë funksione të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore e komuna, dhe a) janë rekrutuar sipas procedurave të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, por që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil; apo b) janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë nëpunës civilë për shkak të ligjit”.*

Dispozitat e mësipërme, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit, për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga strukturat përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil (njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe njësia përgjegjëse, DAP), nëse veprimet e tyre janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit, grupi i mbikëqyrjes verifikoi dhe analizoi të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e shërbimit civil, të tilla si:

- strukturën dhe organikën me të cilën funksiononte institucioni në datën 26.02.2014;
- listë prezencën dhe listë pagesën e punonjësve për muajin shkurt 2014;
- dosjen individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil, etj.).

Në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, për subjektin e mbikëqyrur, konstatohet si më poshtë:

Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të analizuara më sipër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të mbikëqyrur, pasi ka evidentuar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike, listën e punonjësve të administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil; materialet që përmbanin të dhëna lidhur me mënyrën dhe kohëzgjatjen e punësimit të tyre; aktet individuale të emërimit, si dhe materialet shkresore me të dhënat individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike, pas administrimit të dokumentacionit të mësipërm, për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil, ka verifikuar periudhën e punësimit, nëse ishte më shumë se një vit apo më pak se një vit, si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe kërkesave të posaçme për vendin e punës.

Në përfundim të këtyre verifikimeve, ***në datën 30.10.2014***, për institucionin e mbikëqyrur, ka përfunduar procedura e deklarimit të statusit të punësimit. Me shkresën nr. 1606/1 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike, aktet e deklarimit i janë përcjellë drejtuesit të institucionit të mbikëqyrur.

Pasi është njohur me aktet e deklarimit, njësia e burimeve njerëzore pranë institucionit ka konstatuar pasaktësi lidhur me deklarimin e statusit të punësimit për disa prej punonjësve dhe për këtë arsye, me anë të shkresës nr. 546/1 prot., datë 30.04.2015, të Drejtorit Ekzekutiv, ka kërkuar pranë Departamentit të Administratës Publike, një rivlerësim të dosjeve të personelit të AAC.

Nisur nga kërkesa e institucionit, Departamenti i Administratës Publike, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 7, pika 2/c, 3 dhe 4/g, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka përfshirë në proces inspektimi, Autoritetin e Aviacionit Civil, me objekt verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të cilët kanë qenë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (*data 26.02.2014*).

Në përfundim të këtij procesi rivlerësimi, me shkresën nr. 4653 prot., datë 02.10.2015, Departamenti i Administratës Publike ka përcjellë “Raport inspektimi mbi kontrollin e ushtruar në AAC”, me rezultatet si më poshtë:

➤ **Punonjës të punësuar për një periudhë më shumë se një vit, janë evidentuar 27 raste:**

1. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (Akt emërimi nr. 413, datë 22.11.2012).
2. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Kontrollit dhe Sigurisë (Akt emërimi nr. 417, dt. 22.11.2012).
3. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Kontrollit dhe Sigurisë (Akt emërimi nr. 431, dt. 22.11.2012).
4. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (Akt emërimi nr. 416, datë 22.11.2012).
5. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Kontrollit të Personelit (Akt emërimi nr. 407, datë 22.11.2012).
6. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Inspektimit Teknik (Akt emërimi nr. 412, datë 22.11.2012).
7. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit të Personelit (Akt emërimi nr. 312, datë 19.08.2013).
8. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Licencimit të Stafit (Akt emërimi nr. 420, datë 22.11.2012).
9. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Licencimit të Stafit (Akt emërimi nr. 441, datë 22.11.2012).
10. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror (Akt emërimi nr. 421, datë 22.11.2012).

11. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror (Akt emërimi nr. 440, datë 22.11.2012).
12. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Certifikimit Aeroporteve (Akt emërimi nr. 440, datë 22.11.2012).
13. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Certifikimit Aeroporteve (Akt emërimi nr. 455, datë 22.11.2012).
14. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Sigurisë dhe Koordinimit të Emergjencave (Akt emërimi nr. 450, datë 22.11.2012).
15. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Drejtor i Standardizimit Teknik” (Akt emërimi nr. 427, datë 22.11.2012).
16. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Standardizimit Teknik (Akt emërimi nr. 426, datë 22.11.2012).
17. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Standardizimit Teknik (Akt emërimi nr. 332, datë 31.10.2011).
18. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor (Akt emërimi nr. 428, datë 22.11.2012).
19. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Inspektor” në Sektorin e Licencimit OA (Akt emërimi nr. 465, datë 22.11.2012).
20. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Drejtor i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse” (Akt emërimi nr. 404, datë 22.11.2012).
21. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Planifikimit Financiar (Akt emërimi nr. 429, datë 22.11.2012).
22. \*\*\*\*\*, ishte e punësuar në pozicionin “Specialist Finance” (Akt emërimi nr. 423, datë 22.11.2012).
23. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Specialist” në Sektorin të Planifikimit Financiar (Akt emërimi nr. 304, datë 19.08.2013).
24. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Planifikimit Financiar (Akt emërimi nr. 460, datë 22.11.2012).
25. \*\*\*\*\*, ka qenë e punësuar në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve (Akt emërimi nr. 430, datë 22.11.2012).
26. \*\*\*\*\*, ka qenë i punësuar në pozicionin “Specialist” në Sektorin e Përfaqësimit Ligjor (Akt emërimi nr. 448, datë 22.11.2012).
27. \*\*\*\*\*, është emëruar me aktin nr. 444, datë 22.11.2012, të Drejtorit Ekzekutiv të AAC, në pozicionin e punës “Inspektor”, në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, në Drejtorinë e Standardizimit Teknik. (Ky rast do të analizohet me hollësi në vijim të materialit).

Për të gjithë këta punonjës, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, vazhdon marrëdhënia e punës me institucionin, por jo në të njëjtin vend pune dhe për disa prej tyre konstatohet se ushtrajnë detyrën në pozicione pune jo të së njëjtës kategori.

Në lidhje me këtë kategori të punonjësve, u konstatua se është realizuar procesi i deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, me statusin e punësimit “Nëpunës civil”.

## Konkluzion

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, rezultoi se:

- Procedurat e deklarinimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil*”, për këtë kategori punonjësish janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Këta punonjës, në datën 26 Shkurt 2014, ishin të punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, kohëzgjatja e periudhës së punësimit ishte më e madhe se një vit dhe ata plotësojnë kriterin e nivelit arsimor të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin përkatës të punës.
- Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë pasur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.

➤ **Analiza e informacioneve të dërguara nga nëpunësit \*\*\*\*\*\*, me objekt verifikimin e zbatimit të ligjit, duke pretenduar parregullsi në procesin e deklarinimit të statusit të punësimit, si dhe gjatë aplikimit të institutit të transferimit në subjektin e mbikëqyrur.**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet shkresës së protokolluar me nr. 344 prot., datë 30.04.2015 “*Kërkesë*”, është informuar lidhur me parregullsi në procesin e deklarinimit të statusit të punësimit në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, e konkretisht në momentin e vlerësimit të dokumentacionit, për punonjësin \*\*\*\*\*.

Për këtë arsye, Komisioneri ka urdhëruar verifikimin e informacionit, me aktin nr. 344/1 prot., datë 11.05.2015 “*Për verifikimin e informacionit*”, dhe pas kësaj ka filluar procesin duke kërkuar informacion nga institucionet e ngarkuara nga ligji për të realizuar deklarinimin e statusit të punësimit, ndër të cilat prej AAC dhe Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë këtij procesi, Komisioneri është informuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike, me anë të shkresës nr. 1979/1, datë 13.05.2015, se nga ana e këtij institucioni, në mbështetje të kompetencës ligjore për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, ka filluar inspektimi me objekt deklarinimin e statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e gjendur në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar).

Për këtë arsye, me Vendimin nr. 48, datë 21.05.2015, Komisioneri ka urdhëruar pezullimin e procesit të verifikimit, deri në përfundim të rivlerësimit të akteve të deklarinimit të statusit të punësimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike.

Për të ndjekur ecurinë e procesit, është administruar në subjekt një kopje e raportit të inspektimit, e cila është regjistruar në protokollin e Komisionerit me nr. 344/10, datë 21.10.2015. Nga përmbajtja e raportit, konstatohet se ka përfunduar inspektimi i institucionit nga Departamenti i Administratës

Publike, fakt ky që konfirmohet edhe me shkresën nr. 4712/1 prot., datë 22.10.2015, “*Kthim përgjigje*”, me të cilën na është dërguar edhe një kopje e raportit të inspektimit.

Ndërsa në lidhje me përfundimin e procesit të rregullimit të situatës ligjore, për rikthimin e këtij punonjësi në pozicionin ku është konfirmuar, nëpërmjet shkresës nr. 4712/1 prot., datë 22.10.2015, “*Kthim përgjigje*”, Departamenti i Administratës Publike, ka vënë në dijeni Komisionerin se në këtë rast, procesi ende nuk ka përfunduar, pasi rivendosja e ligjshmërisë do të finalizohet me krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil, me qëllim implementimin e strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 26.02.2014, e Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil*”.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 11, pika 1 dhe nenit 14, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 344/12, datë 06.11.2015, “*Kërkesë për informacion të mëtejshëm*”, ka kërkuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe subjektit të inspektimit, në këtë rast Autoriteti i Aviacionit Civil, të njoftohet në kohë reale, për të gjitha fazat nëpërmjet të cilave do të kalojë ky proces, duke dërguar aktet administrative që e materializojnë atë, deri në përfundim të ristrukturimit të institucionit.

Në vijim të korrespondencës, me institucionin e inspektuar, rezulton se ky i fundit, me anë të shkresës nr. 2, datë 05.01.2016 “*Kthim përgjigje*”, i ka kërkuar Komisionerit që verifikimi i procesit të ristrukturimit, të realizohet në një kohë të mëvonshme, me argumentin se në të njëjtën kohë, institucioni do të përfshihej edhe në disa auditime ndërkombëtare, në lidhje me fushën e tij të veprimit.

Më tej, në ndjekje të zgjidhjes së rastit, Komisioneri ka kërkuar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe subjektit të inspektimit, Autoritetit të Aviacionit Civil, nëpërmjet shkresës nr. 252/1 prot., datë 11.04.2017, të njoftohet në lidhje me ecurinë e procesit, por nuk ka marrë përgjigje.

Ndërkohë, pas pezullimit të verifikimit të rastit, Komisioneri ka marrë informacione të përsëritura nga punonjës të institucionit, ku pretendohet se ende rezultojnë parregullsi në lidhje me administrimin e shërbimit civil nga ana e Autoritetit të Aviacionit Civil. Konkretisht, në informacionet e ardhura, regjistruar me shkresat nr. 252 prot., dt. 04.04.2017 dhe nr. 252/2 prot., dt. 14.09.2017, nëpunësi \*\*\*\*\* ka pretenduar se çështja e tij, lidhur me ristrukturimin e institucionit, ende nuk ka marrë zgjidhje dhe për këtë arsye ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit, për rregullimin e ligjshmërisë gjatë këtij procesi.

Në këto rrethana, me qëllim që t’i hapet rruga vazhdimit të hetimit për gjendjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, Komisioneri, nëpërmjet vendimit nr. 201, datë 04.10.2017 “*Për heqjen e masës së pezullimit për procesin e verifikimit të statusit të punësimit në institucionin, Autoriteti i Aviacionit Civil, miratuar me vendimin e pezullimit nr. 48, datë 21.05.2015, të Komisionerit*”, urdhëroi:

1. Heqjen e masës së pezullimit për procesin e verifikimit të statusit të punësimit në institucionin, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe fillimin e mbikëqyrjes tematike në këtë institucion, për shkak të rëndësisë së problematikave të rastit.
2. Verifikimi i nisur me urdhrin nr. 344/1 prot., datë 11.05.2015 “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësi \*\*\*\*\*”, të bashkohet me mbikëqyrjen tematike dhe të trajtohet sipas programit të mbikëqyrjes.

Në këto kushte, filloi procesi i mbikëqyrjes dhe pasi grupi i punës u njoh me përmbajtjen e dokumentacionit të paraqitur nga ana e punonjësit, me veprimet administrative të kryera nga institucioni i AAC në lidhje me punonjësin \*\*\*\*\*, si dhe pasi administroi aktet që i materializojnë ato, konstaton se:

Punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar me aktin nr. 444, datë 22.11.2012, të Drejtorit Ekzekutiv të AAC, në pozicionin e punës “Inspektor”, në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, në Drejtorinë e Standardizimit Teknik, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Më pas, me urdhrin nr. 302, datë 30.04.2014, të titullarit të institucionit, ka kaluar në pozicionin e punës “Jurist”, në Aeroportin e Kukësit, pozicion i cili aktualisht trajtohet sipas kodit të punës, pasi nuk është pjesë e strukturës dhe organikës së institucionit të AAC.

Nga sa më sipër, konstatohet se nëpunësi \*\*\*\*\* në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i emëruar në pozicionin e punës “Inspektor”, në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, për një periudhë më tepër se një vit.

Për këtë arsye, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit të sipërcituar, për punonjësin \*\*\*\*\* duhet të kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “Nëpunës civil”, në pozicionin “Inspektor”, në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, në Drejtorinë e Standardizimit Teknik, në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Nga hetimi administrativ rezulton se, gjatë procesit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e AAC, Departamenti i Administratës Publike nuk ishte shprehur mbi statusin e punësimit të punonjësit në fjalë.

Me shkresën nr. 1979/1, datë 13.05.2015 “Kthim përgjigje”, Departamenti i Administratës Publike sqaron se, “deklarimi i statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\* nuk është kryer, pasi nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit të AAC, nuk është përcjellë dosja individuale e këtij punonjësi”. Për këtë arsye, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, nëpërmjet shkresës nr. 546/1, datë 30.04.2015, ka rivlerësuar praktikën e deklarimit të statusit të punësimit për të gjithë nëpunësit/punonjësit e institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nëpërmjet një procesi inspektimi.

Në përfundim të procesit, në përmbajtje të raportit përfundimtar, Departamenti i Administratës Publike, pas verifikimit të dosjes individuale të nëpunësit \*\*\*\*\* mënyrës së fillimit të



marrëdhënieve financiare dhe plotësimit të kriterëve të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, ka rregulluar gjendjen e paligjshmërisë, duke deklaruar statusin e punësimit “Nëpunës civil”, për punonjësin në fjalë, në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror”, në Drejtorinë e Standardizimit Teknik, në Autoritetin e Aviacionit Civil (faqe 38 e raportit).

Nga verifikimi i materialeve të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se pozicioni ku punonjësi \*\*\*\*\* ushtron aktualisht detyrën (“Jurist”, në Aeroportin e Kukësit), nuk klasifikohet në pozicionet që janë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për këtë arsye, në kuadër të zbatimit të raportit të DAP, nëpunësi \*\*\*\*\* ka kërkuar vazhdimisht rikthimin e tij në një nga pozicionet e shërbimit civil të institucionit, kërkesë e cila rezulton të mos jetë zbatuar deri në momentin e fillimit të mbikëqyrjes, fakt që materializohet dhe në ankesat e paraqitura nga ky punonjës pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (Shkresa nr. 252 prot., datë 04.04.2017 dhe shkresa nr. 252/2 prot., datë 14.09.2017).

### **Konkluzion:**

Nga sa u analizua më sipër, prej Komisionerit vlerësohet se akti nr. 302, datë 30.04.2014, i Drejtorit Ekzekutiv të AAC, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Jurist”, në Aviacionin e Kukësit, i cili nuk klasifikohet si pozicion i shërbimit civil, është një akt absolutisht i pavlefshëm. Kjo për faktin se, në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve normative të dala në zbatim të tij, në rastin konkret, titullari i institucionit të ACC ka vepruar në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të legjislacionit në fuqi lidhur me kompetencën e organit publik, pasi ai nuk është organi kompetent për emërimin, transferimin e përkohshëm ose të përhershëm, si dhe lirimin nga shërbimi civil për nëpunësin civil. Këto veprime administrative, në përputhje me Kreun IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 22 deri 26, e në vijim të ligjit për nëpunësin civil, janë kompetencë e njësisë përgjegjëse, DAP dhe/ose të njësisë së burimeve njerëzore, sipas rasteve specifike.

Në këto rrethana, në kuptim të nenit 108, germa “a”, pika i), të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, akti i emërimit për punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin “Jurist”, në Aeroportin e Kukësit, është një akt absolutisht i pavlefshëm, dhe në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1 të po këtij ligji, akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Për rregullimin e paligjshmërisë në këtë rast, në kuptim të nenit 111, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të ndiqen hapat si më poshtë:

- Drejtori Ekzekutiv i Aviacionit Civil, duhet të konstatojë menjëherë si absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 302, datë 30.04.2014, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Jurist”, në Aeroportin e Kukësit.
- Drejtori Ekzekutiv i Aviacionit Civil, në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, si dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit të AAC, duhet të rregullojnë pasojat e pavlefshmërisë absolute të aktit të mësipërm, duke e rikthyer nëpunësin \*\*\*\*\* në

një pozicion të barasvlershëm me pozicionin “Inspektor në Sektorin e Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror”, ku ai ka qenë i emëruar në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për shërbimin civil, pasi kjo emërtesë nuk ekziston aktualisht në strukturën e institucionit, si dhe gjithë të drejtat e tjera që sigurohen nga ligji për nëpunësin civil.

**Konstatim:**

Në lidhje me këtë rast, Komisioneri konstaton se, nga ana e subjektit të mbikëqyrur janë paraqitur observacione me shkresën nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018, në të cilën ka informuar se nëpunësi \*\*\*\*\* është rikthyer në Autoritetin e Aviacionit Civil, sipas rekomandimeve të lëna në projektraport. Nga analiza e dokumentacionit shoqërues të observacioneve, rezulton se institucioni nuk ka bashkëlidhur aktin përkatës, i cili vërteton zhvillimin e këtij veprimi administrativ.

Në këto kushte, Komisioneri çmon se, kryerja e detyrave të përcaktuara në këtë rubrikë të raportit, do të ndiqet më tej nga grupi i punës, i cili do të verifikojë zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit, pas përfundimit të afatit kohor që do të përcaktohet në këtë rast.

➤ **Punonjës të punësuar për një periudhë më pak se një vit, janë evidentuar 12 raste:**

1. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes (Akt emërimi nr. 40, dt. 29.01.2014).
2. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (Akt emërimi nr. 10, datë 10.01.2014).
3. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë (Akt emërimi nr. 20, datë 15.01.2014).
4. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Drejtor, i Kontrollit të Shërbimit Ajror (Akt emërimi nr. 34, dt. 25.10.2013).
5. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Teknik (Akt emërimi nr. 112, dt. 02.12.2013).
6. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Drejtor i Sigurisë Ajrore (Akt emërimi nr. 45, dt.28.10.2013).
7. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Drejtor, i Drejtorisë së Aeroporteve dhe Sigurisë (Akt emërimi nr. 41, dt. 28.10.2013).
8. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Drejtor i Zhvillimit Ajror (Akt emërimi nr. 329, dt.25.10.2013).
9. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Mbikëqyrjes së ZMSHA (Akt emërimi nr. 144, dt. 30.12.2013).
10. \*\*\*\*\* , ishte e punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Licencimit OA (Akt emërimi nr. 39, dt. 29.01.2014).
11. \*\*\*\*\* , e punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Sigurisë (Akt emërimi nr.333, dt. 04.09.2013).
12. \*\*\*\*\* , punësuar në pozicionin Inspektor, në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Certifikimit Aeroporteve (Akt emërimi nr. 17, dt. 15.01.2014).

Për rastet në kategorinë “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, kanë përfunduar afatet për deklarimin e statusit të punësimit, të përcaktuara në ligj, por në asnjë rast nuk është përfunduar procedura për konfirmimin e nëpunësit.

### **Konkluzion:**

- Procedurat e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për punonjësit e mësipërm janë kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- Nga këqyrja dhe analiza e akteve të emërimit, nivelit të diplomës së arsimit të lartë për pozicionet përkatëse të punës dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë pasur më pak se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.
- Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse (DAP), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit “*Nëpunës civilë në periudhë prove*”.
- Për të gjithë nëpunësit, aktualisht ka përfunduar periudha e provës dhe është realizuar programi i trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë nga ASPA. Në dosjet e këtyre nëpunësve janë të administruara certifikatat përkatëse të lëshuara nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA), por procedura specifike e kërkuar nga ligji në mbarim të periudhës së provës, nuk ka përfunduar, pasi në asnjë rast nuk është finalizuar procesi me aktet përkatëse të konfirmimit të nëpunësit, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

### **Konstatim:**

Duke u nisur nga këqyrja dhe administrimi i dokumentacionit të mbikëqyrjes, evidentohet fakti se Departamenti i Administratës Publike, nëpërmjet shkresës nr. 4653 prot., dt. 02.10.2015, “*Dërgim i raportit të inspektimit mbi kontrollin e ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil*”, ka dërguar pranë institucionit të AAC, Raportin Përfundimtar të inspektimit për verifikimin e statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual në këtë institucion, i cili nuk është shoqëruar me aktet individuale të deklarimit të statusit të punësimit për secilin punonjës, sipas konstatimeve në përmbajtjen e këtij akti kontrolli, detyrim i cili lind nga neni 67, pika 6, e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, Departamenti i Administratës Publike duhet të finalizojë menjëherë procesin, duke nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit në përputhje me konstatimet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Inspektimit, të kryer pranë AAC, si dhe duke mbajtur parasysh orientimet e Komisionerit në materialin që finalizon mbikëqyrjen në këtë institucion.

➤ **Punonjës në pritje të plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës, si dhe punonjës për të cilët nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi dosja nuk ka genë e plotë:**

**a. Punonjës në pritje të plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës:**

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se për **2 punonjës**, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, Departamenti i Administratës Publike i ka klasifikuar si “*Punonjës në pritje të kriterit të nivelit të diplomës*”. Bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin e Inspektimit Operacional*”, emëruar me urdhrin nr. 2/7, datë 01.07.2010;
2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor në Sektorin Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajrorë*”, emëruar me urdhrin nr. 41, datë 29.01.2014

Në përputhje me parashikimet e kreut III, pika 6/1, të vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, për punonjësit e mësipërm, Departamenti i Administratës Publike, ka deklaruar statusin e punësimit, si “*nëpunës në pritje të kriterit të nivelit të diplomës*”.

Akti nënligjor, i përmendur më sipër, parashikon se: “*Punonjësit e institucioneve të varësisë, pjesë e administratës shtetërore, të cilët bëhen pjesë e shërbimit civil, si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe që në momentin e deklarimit të statusit nuk plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, të pozicionit të punës ku janë të emëruar, të vazhdojnë të punojnë në pozicionin ku janë të emëruar, me kushtin që, brenda një afati 2-vjeçar, t’i plotësojnë këto kushte*”. Më tej, në pikën 6, të kreut IV, me nëntitull “*Dispozita transitore*”, të këtij akti nënligjor, është parashikuar se: “*Afati 2-vjeçar, i përmendur në pikën 6/1, të kreut III, të këtij vendimi, fillon nga data 1 shtator 2014*”.

Nisur nga fakti që njësia përgjegjëse, DAP, ka përfunduar procedurën e deklarimit të statusit të punësimit në institucionin e AAC, në datën 30.10.2014, afati 2-vjeçar i plotësimit të kriterit arsimor, përfundon në datën 30.10.2016, kjo në përputhje me ndryshimet që pësoi akti normativ i mësipërm, me vendimin nr. 627, datë 24.09.2014, ku në kreun IV të tij, përcaktohet se, shtyrja e afatit për përfundimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, nuk mund të jetë më vonë se data 30.10.2014.

Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se punonjësit në fjalë, nuk kanë dorëzuar dokumente që të provojnë përmbushjen e kriterit të nivelit të arsimit të kërkuar.

- Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*, konstatohet se, në zbatim të Lidhjes nr. 2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, ndër kërkesat e posaçme të pozicionit të punës “*Përgjegjës Sektori*”, lidhur me arsimin, është përcaktuar “*Master Shkencor*”. Nga verifikimi i dosjes individuale të këtij punonjësi, rezulton se ai zotëron diplomë të Universitetit të Padovas,

Itali, në degën "Ekonomi-financë", e cila sipas dëshmisë nr. 1932, datë 02.09.2009, të Ministrisë së Arsimit, është njehsuar si diplomë e nivelit "Bachelor".

- Në rastin e punonjësit \*\*\*\*\*\*, në zbatim të Lidhjes nr. 2, të aktit normativ të sipërcituar, ndër kërkesat e posaçme të pozicionit të punës "Inspektor", pozicioni i cili klasifikohet si pozicioni i nivelit ekzekutiv, i klasës IV/A, me emërtesën "Specialist i nivelit A", lidhur me arsimin është përcaktuar "Master Profesional". Aktualisht, nga verifikimi i dosjes individuale, rezulton se ky punonjës zotëron vetëm diplomë të Shkollës së Lartë të Oficerëve të Aviacionit, lëshuar në vitin 1979. Sipas shkresës nr. 313/1 prot., datë 04.01.2015, të Ministrisë së Mbrojtjes "Mbi nivelin e diplomave të lëshuara nga shkollat/akademietë ushtarake të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes", diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë ushtarak, në periudhën 1973-1987, janë njehsuar si diploma të nivelit "Bachelor".

### **Konkluzion:**

Nga sa analizuam më sipër, konstatohet se, punonjësit e mësipërm, për të cilët Departamenti i Administratës Publike ka deklaruar statusin e punësimit si "Nëpunës në pritje të plotësimit të kriterit të diplomës", nuk plotësojnë kriteret për të qenë nëpunës civil, pasi rezulton të mos zotërojnë diplomë sipas kërkesave të posaçme të pozicionit të punës, ku ata janë të emëruar.

Për rregullimin e paligjshmërisë, në zbatim të Kreut III, pika 6/2, të vendimit nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se: "Për punonjësit, të cilët nuk plotësojnë kushtet sipas pikës 6/1 të kreut III të këtij vendimi, në përfundimin të afatit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike njofton njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës, i cili vendos përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës", njësia përgjegjëse DAP, duhet të njoftojë njësinë e burimeve njerëzore të institucionit për mos plotësimin e kushteve ligjore për të punuar në një pozicion të caktuar të shërbimit civil. Pas kësaj, njësia e burimeve njerëzore, pranë AAC, duhet të përmbyllë procesin, duke vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*\*, me këtë institucion.

### **b. Punonjës për të cilët nuk është deklaruar statusi i punësimit, pasi dosja nuk ka qenë e plotë:**

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se në **I rast**, në momentin e deklarimit të statusit të punësimit, Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur dhe bëhet fjalë për punonjësën \*\*\*\*\*\*, e punësuar në pozicionin "Inspektor në Sektorin e Inspektimit Operacional", emëruar me urdhrin nr. 18, datë 15.01.2014.

Konstatohet se me aktin nr. 1606/4, datë 30.10.2014, Departamenti i Administratës Publike ka vendosur të mos shprehet në lidhje me statusin e punësimit për këtë punonjëse, me arsyetimin se dokumentacioni në dosjen e punës nuk është i plotë, pasi nuk është bërë njehsimi i diplomës së studimeve universitare të përfituar jashtë vendit.

Nga verifikimi i dosjes individuale, rezulton se nëpunësja \*\*\*\*\* disponon diplomë të Universitetit të Rumanisë, në Fakultetin e Marrëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare, diplomë e cila, në momentin e procesit të deklarimit të statusit të punësimit, nuk ka qenë e njehsuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në kuptim të nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “*Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, vlerësohet se, Departamenti i Administratës Publike ka vepruar drejt në rastin e nëpunëses \*\*\*\*\* , pasi diplomat universitare të përfituara jashtë vendit, duhet të njehsohen me një diplomë shqiptare, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimin dhe *e së drejtës së punësimit*. Kjo dhe për faktin se, në Lidhjen nr. 2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, ndër kriteret e posaçme në lidhje me arsimin për pozicionet e shërbimit civil, është njehsimi nga institucionet përgjegjëse i diplomave të cilat janë marrë jashtë vendit.

Aktualisht, referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, konkretisht Vërtetimit nr. 21545/1 prot, datë 06.05.2015, të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, rezulton se kjo punonjëse ka nisur procedurat për njohjen e diplomës për studimet e kryera në Akademinë e Studimeve Ekonomike të Bukureshtit, Rumani.

#### **Konkluzion:**

Në këto kushte, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike duhet të përfundojë procedurën dhe në përfundim të shprehet për statusin e punësimit të kësaj punonjëse.

#### **Konstatim:**

**b** - Komisioneri konstaton se, institucioni i mbikëqyrur në observacionet e sjella me shkresën nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018, “*Kthim përgjigje*”, ka informuar se në lidhje me detyrat e lëna për rregullimin e paligjshmërisë së konstatuar në rastin e nëpunësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , janë pritje të veprimit të Departamentit të Administratës Publike.

Në këto kushte, Komisioneri çmon se, kryerja e detyrave të përcaktuara në pikën a) dhe b), në këtë rubrikë të raportit, do të ndiqet më tej nga grupi i punës, i cili do të verifikojë zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit, pas përfundimit të afatit kohor që do të përcaktohet në këtë rast.

### ***III. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.***

Nga dokumentacioni i administruar gjatë mbikëqyrjes, rezulton se pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, konkretisht në momentin e miratimit të ndryshimeve në strukturë (*miratuar me vendimin nr. 100, datë 26.02.2014 i Këshillit të Ministrave*,

*i cili ka hyrë në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare nr. 28 në datë 11.03.2014 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 791, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të organikës, si dhe të nivelit të pagave të administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil”*), në institucion kanë vijuar emërimet e nëpunësve, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, në kundërshtim flagrant me parimet e sanksionuara në legjislacionin e shërbimit civil dhe procedurat specifike të pranimit në shërbimin civil, në **31 raste**, sipas analizës që do të vijojë.

**A. Refuzimi i deklaramit të statusit të punësimit nga DAP, për arsye të emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, pas datës së fillimit të efekteve të tij.**

Sipas akteve të administruara, konstatohet se në **11 raste**, njësia përgjegjëse (DAP), ka refuzuar të deklarojë statusin e punësimit për punonjësit e referuar nga institucioni i AAC, pasi ata ishin emëruar në pozicione të shërbimit civil, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014). Me shkresën nr. 4653, datë 02.10.2015, “*Dërgim i raportit të inspektimit mbi kontrollin e ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil*”, Departamenti i Administratës Publike ka vënë në dijeni titullarin e institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, lidhur me rastet kur punonjësit nuk mund të deklarohen si nëpunës civilë, pasi akti i emërimit në detyrë ka dalë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe duke mos respektuar procedurën ligjore të pranimit në shërbimin civil.

Kjo do të thotë, që në këtë rast, këta punonjës nuk janë subjekte të zbatimit të nenit 67, pasi ata janë emëruar nëpërmjet një akti administrativ absolutisht të pavlefshëm nga ana e titullarit të institucionit, i cili nuk sjell pasoja juridike, ashtu si do të analizohet me hollësi edhe në vijim të kësaj rubrike.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Specialist këshilltar*”, në Sektorin e Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 129, datë 12.03.2014.
2. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit*”, emëruar me urdhrin nr. 300, datë 30.04.2014.
3. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes Koncesioneve*”, emëruar me urdhrin nr. 190, datë 12.03.2014.
4. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes Koncesioneve*”, emëruar me urdhrin nr. 192, datë 12.03.2014.
5. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes*”, emëruar me urdhrin nr. 142, datë 12.03.2014.
6. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Sigurisë*”, emëruar me urdhrin nr. 183, datë 12.03.2014.
7. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Sigurisë*”, emëruar me urdhrin nr. 189, datë 12.03.2014.
8. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Certifikimit të Personelit*”, emëruar me urdhrin nr. 149, datë 17.03.2014.

9. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Standardizimit Teknik*”, emëruar me urdhrin nr. 292, datë 25.04.2014.
10. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Mbikëqyrjes dhe Licencimit OA*” emëruar me urdhrin nr. 293, datë 25.04.2014.
11. \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës “*Inspektor i Standardizimit Teknik*” emëruar me urdhrin nr. 294, datë 25.04.2014.

Aktet e emërimit për këta punonjës kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23, të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi.

Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në dispozitat e mësipërme, në kuptim të nenit 116, pika c, të ligjit nr. 8485/1999 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” (ligj i cili ka qenë në fuqi në momentin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit), përcakton pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e mësipërm.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 7, Kreut III, të vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*”, Departamenti i Administratës Publike ka vepruar drejt duke refuzuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit e mësipërm, pasi aktet e tyre të emërimit kanë dalë pas hyrjes në fuqi të ligjit për shërbimin civil.

Sipas listë prezencës dhe listë pagesës së muajit Shtator 2017, konstatohet se, këta punonjës vazhdojnë të ushtrojnë detyrën në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, edhe pse Raporti i Inspektimit i DAP, i është njoftuar institucionit në datën 02.10.2015.

Nga ana tjetër, nga mbikëqyrja nuk është evidentuar asnjë akt shkresor, që nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të jetë bërë ndonjë përpjekje për të informuar DAP për vijimësinë e procesit, ose titullarin e institucionit në lidhje me rivendosjen e ligjshmërisë në këtë rast.

### ***Konkluzion:***

Në këtë rast, vlerësohet se Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke refuzuar deklarimin e statusit të punësimit për këta punonjës, pasi ata janë emëruar në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, pas fillimit të efekteve juridike të tij, si dhe duke njoftuar drejtuesin e institucionit për këtë fakt.

Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, drejtuesi i institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, pas njohjes me Raportin e Inspektimit, të dërguar nga DAP, në cilësinë e organit publik që i ka nxjerrë këto akte, si dhe bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, në të cilin parashikohet shprehimisht se, “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për*



*rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*", duhet të konstatonte si absolutisht të pavlefshme, aktet administrative për emërimin e 11 punonjësve të evidentuar më sipër, si akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me kërkesat ligjore dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe të rregullonte pasojat, duke ndërprerë marrëdhënien financiare të këtyre punonjësve, me qëllim që pozicionet e zëna në kundërshtim me ligjin, të shpallen si të lira dhe të plotësohen sipas ligjit.

Në këto rrethana, për të rregulluar ligjshmërinë, drejtuesi i institucionit duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit dhe të rregullojë pasojat duke nxjerrë aktet individuale të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe ato financiare për punonjësit e evidentuar më sipër.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Nga ana tjetër, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në këtë institucion, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të ndjekin procesin dhe të luajnë një rol aktiv, në drejtim të mbështetjes së titullarit të institucionit me asistencë teknike për të rregulluar situatën dhe për të rivendosur ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil.

**B. Emërimet në kundërshtim me ligjin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në 20 raste.**

Me gjithë konstatimin nga ana e Departamentit të Administratës Publike, për pavlefshmëri absolute të akteve të emërimit duke mos respektuar procedurat ligjore të rekrutimit dhe pavarësisht ndalimit të ligjit për nëpunësin civil, në nenin 23, pika 4 të tij, ku përcaktohet se çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm, në këtë institucion, **në 20 raste**, kanë vijuar emërimet e nëpunësve, nëpërmjet akteve të nxjerra nga Drejtori i Ekzekutiv, duke mos respektuar procedurat e rekrutimit të parashikuara nga ligji nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në këtë kategori emërimesh përfshihen punonjësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\* , emëruar "*Përgjegjës në Sektorin e Informacionit*", me aktin nr. 459, datë 04.10.2016, të Drejtorit Ekzekutiv.
2. \*\*\*\*\* , emëruar "*Specialist në Sektorin e Informacionit*", me aktin nr. 231, datë 20.4.2017, të Drejtorit Ekzekutiv.
3. \*\*\*\*\* , emëruar "*Inspektor i Licencimit të Personelit*", me aktin nr. 464, datë 10.10.2016, të Drejtorit Ekzekutiv.
4. \*\*\*\*\* , emëruar "*Inspektor i Mbikëqyrjes Teknike*", me aktin nr. 389, datë 24.07.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
5. \*\*\*\*\* , emëruar "*Inspektor i Mbikëqyrjes Operacionale*", me aktin nr. 596, datë 30.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
6. \*\*\*\*\* , emëruar "*Inspektore e Vlefshmërisë Ajrore*", me aktin nr. 544, datë 09.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv

7. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Parrezikshmërisë dhe Certifikimit*”, me aktin nr. 191, datë 24.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
8. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes së Masterplaneve*”, me aktin nr. 233, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
9. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Mbikëqyrjes së Masterplaneve*”, me aktin nr. 236, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
10. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Certifikimit të Personelit të Sigurisë*”, me aktin nr. 170, datë 15.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
11. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Certifikimit të Personelit të Sigurisë*”, me aktin nr. 229, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
12. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Standardizimit Teknik*”, me aktin nr. 232, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
13. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 197, datë 31.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
14. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 235, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
15. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror*”, me aktin nr. 227, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
16. \*\*\*\*\*, emëruar “*Përgjegjës i Licencimit, Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror*”, me aktin nr. 505, datë 10.11.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
17. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, me aktin nr. 171, datë 15.03.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
18. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, me aktin nr. 239, datë 20.04.2017, të Drejtorit Ekzekutiv
19. \*\*\*\*\*, emëruar “*Përgjegjës i Prokurimeve dhe Shërbimeve*”, me aktin nr. 591, datë 30.12.2016, të Drejtorit Ekzekutiv
20. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i Prokurimeve dhe Shërbimeve*”, me aktin nr. 230, datë 20.4.2017, të Drejtorit Ekzekutiv.

### **Konkluzion:**

Në këtë rast, Komisioneri vëren se, këto akte kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duhen respektuar detyrimisht kërkesat për një procedurë të rregullt konkurrimi.

Titullari i institucionit ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Drejtorit Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës dhe atë financiare të punonjësve të emëruar në këtë mënyrë dhe të evidentuar më sipër dhe për rregullimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, duhet që procedura për plotësimin e këtyre pozicioneve të punës të kryhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, fillimisht duhet të planifikojë nevojat e rekrutimit dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të vijojë procesin e plotësimit të tyre sipas ligjit.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

#### ***Konstatim:***

c - Komisioneri konstaton se, në observacionin e sjellë nëpërmjet shkresës nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018, institucioni Autoriteti i Aviacionit Civil pretendon se, në zbatim të rekomandimeve të lëna në projektraport deri në muajin shkurt 2018 janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për 29 punonjës të emëruar me akte të përkohshme emërimi.

Në lidhje me punonjësen \*\*\*\*\*, për të cilën është kërkuar ndërprerja e marrëdhënies financiare, institucioni informon se, kjo nëpunëse gëzon statusin e nëpunësit civil, të njohur nga Këshilli i Qarkut Tiranë dhe për këtë arsye janë në pritje të veprimit të Departamentit të Administratës Publike.

Në këto kushte, për të vlerësuar rrethanat e rastit, u verifikua dokumentacioni përkatës, i dërguar nga institucioni, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se:

Dokumentacioni i dërguar për procedurën e ndërprerjes së marrëdhënies financiare për 29 punonjësit e sipër përmendur, është i paplotë, pasi mungojnë aktet administrative të cilat materializojnë zhvillimin e këtyre veprimeve administrative dhe si rrjedhojë nuk mund të arrihet në një vlerësim të drejtë, nëse janë zbatuar të gjitha kërkesat ligjore.

Njëkohësisht, në observacionin e institucionit të mbikëqyrur nuk është bashkëlidhur asnjë akt administrativ që të vërtetojë statusin e nëpunësit civil për punonjësen Stela Rrumbullaku.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson përpjekjet e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë, por çmon se, në kushtet kur konstaton që aktet të cilat vërtetojnë rregullimin e ligjshmërisë në këtë aspekt,

kryerja e detyrave të përcaktuara në pikat e kësaj rubrike të raportit, do të ndiqet më tej nga grupi i punës, i cili do të verifikojë zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit, pas përfundimit të afatit kohor, që do të përcaktohet në këtë rast.

#### **IV. Lëvizjet paralele dhe ngritjet në detyrë, pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan lëvizjet paralele dhe ngritjet në detyrë, të kryera nga data 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes dhe rezultoi si më poshtë:

- a) Për periudhën objekt mbikëqyrje, janë evidentuar **3 pozicione të kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese**, të cilat janë plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit të përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Në këtë rast, bëhet fjalë për punonjësit:

- \*\*\*\*\*, emëruar Drejtor i Mbikëqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve, me urdhrin nr. 450, datë 29.9.2016, të Drejtorit Ekzekutiv. Kjo punonjëse është emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit Operacional”, me urdhrin nr. 18, datë 15.01.2014, të Drejtorit Ekzekutiv. Emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Informacionit”, me aktin nr. 132, datë 12.3.2014, të Drejtorit Ekzekutiv, në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil.
- \*\*\*\*\*, emëruar Drejtor i Administratës dhe Shërbimeve, me urdhrin nr. 128, datë 12.3.2014, të Drejtorit Ekzekutiv. (emëruar në pozicionin “Inspektor i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Certifikimit të Aeroporteve” me aktin nr. 17, datë 15.1.2014).
- \*\*\*\*\*, emëruar Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Kontabilitetit, me urdhrin nr. 504, datë 10.11.2016 të Drejtorit Ekzekutiv. (emëruar në pozicionin “Inspektor i Sigurisë dhe Koordinimit të Emergjencave” me aktin nr. 333, datë 04.9.2013).

Nga verifikimi dhe këqyrja e dokumentacionit, rezulton se këta nëpunës janë punonjës ekzistues (hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil). Emërimi i tyre në pozicionet aktuale, të cilat sipas rastit janë pozicione të kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese, është bërë vetëm me një urdhër të drejtuesit të institucionit, pa u zbatuar më parë procedura e konkurrimit për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, të përcaktuara nga neni 26, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreu III, i vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” e për këtë arsye këto akte emërimi janë absolutisht të pavlefshëm.

### **Konkluzion:**

Komisioneri vlerëson se, në kuptim të nenit 108, pika “a”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktet e emërimit në pozicionin aktual për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, janë nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në këtë rast, nuk janë zbatuar procedurat e konkurrimit për lëvizje paralele apo ngritje në detyrë, të përcaktuara nga neni 26, i ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreu III i vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Në kuptim të nenit 108, pika “a”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktet e emërimit për punonjësit si më sipër, janë akte absolutisht të pavlefshme dhe në kuptim të nenit 110, pika 1, të po këtij ligji, këto akte nuk sjellin asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse janë konstatuar si të tilla apo jo. Për rregullimin e paligjshmërisë në këtë rast, në kuptim të nenit 111, të Kodit të Procedurës Administrative, në rastin e punonjësve si më sipër duhet të konstatohet pavlefshmëria absolute e akteve nga organi që i ka nxjerrë, që është Drejtori Ekzekutiv i AAC, të ndërpriten marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me funksionin përkatës dhe punonjësit të trajtohen sipas kategorisë në të cilën aktualisht ata e gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

#### *b) Lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive apo në nivel të ulët dhe të mesëm drejtues.*

Gjatë verifikimit në institucion, konstatohet se në **39 raste**, nëpunësit janë emëruar në pozicione të së njëjtës kategori në shërbimin civil, ose në kategori të ndryshme, duke mos zbatuar procedurat e kërkuara nga ligji në këtë drejtim. Nisur nga vlerësimi i aspektit ligjor, këto lëvizje mund të kategorizohen si lëvizje paralele, që janë aplikuar me akt emërimi të nxjerrë nga titullari i institucionit, ose si emërimë në kushtet e riorganizimit të institucionit për shkak të implementimit të strukturës së re.

Në të dyja rastet, konstatohet se aktet kanë dalë duke mos respektuar asnjë procedurë ligjore të parashikuar nga neni 25, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, të përcaktuar në kreun VII, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, në rastin e lëvizjes paralele, si dhe procedurat e kërkuara nga neni 50, i ligjit në fjalë, në rastin e riorganizimit të institucionit, pas përfshirjes së tij në shërbimin civil.

Ky konstatim materializohet në tabelën në vijim, ku janë evidentuar nëpunësit civilë që janë gjendur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, lëvizjet e tyre gjatë kësaj periudhe, si dhe pozicioni aktual i tyre në momentin e mbikëqyrjes.

Tabela nr. 1 *Transferimet e nëpunësve civilë të AAC, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv, pas miratimit të strukturës.*

<b>Nr.</b>	<b>Emër mbiemër</b>	<b>Pozicioni i punës (datë 26.02.2014)</b>	<b>Pozicioni i punës (struktura e 2017)</b>	<b>Akti i emërimit në pozicionin aktual</b>
<b>Lëvizje paralele</b>				
1.	*****	Drejtor, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Drejtor Drejtorja e Kontrollit dhe Cilësisë	Urdhër nr. 138, datë 12.03.2014
2.	*****	Inspektor, Sektori i Kontrollit të Cilësisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Inspektor, Sektori i Kontrollit të Cilësisë, Drejtoria e Kontrollit dhe Cilësisë	Urdhër nr. 301, datë 30.04.2014
3.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Përgjegjës Sektori Sektori i Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë, Drejtoria e Kontrollit dhe Cilësisë	Urdhër nr. 173, datë 12.03.2014
4.	*****	Inspektor Sektori i sistemit të menaxhimit të sigurisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Inspektor Sektori i sistemit të menaxhimit të sigurisë, Drejtoria e Kontrollit dhe Cilësisë	Urdhër nr. 177, datë 12.03.2014
5.	*****	Inspektor Sektori i sistemit të menaxhimit të sigurisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Inspektor Sektori i sistemit të menaxhimit të sigurisë, Drejtoria e Kontrollit dhe Cilësisë	Urdhër nr. 176, datë 12.03.2014
6.	*****	Drejtor, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Lundrimit Ajror	Drejtor, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 137, datë 12.03.2014
7.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Kontrollit të Personelit, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Lundrimit Ajror	Përgjegjës Sektori, Sektori i Licencimit të personelit inxhinier-technik dhe operacional, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 160, datë 12.03.2014
8.	*****	Inspektor Sektori i Kontrollit të Personelit, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Lundrimit Ajror	Inspektor, Sektori i Licencimit të personelit inxhinier-technik dhe operacional, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të LA	Urdhër nr. 157, datë 12.03.2014
9.	*****	Inspektor Sektori i Kontrollit të Personelit, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Lundrimit Ajror	Inspektor, Sektori i Mbikëqyrjes Operacionale, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 163, datë 12.03.2014
10.	*****	Inspektor Sektori i Inspektimit Teknik, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të LA	Inspektor Sektori i Mbikëqyrjes Teknike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 162, datë 12.03.2014
11.	*****	Inspektor Sektori i Inspektimit Teknik, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të LA	Inspektor, Sektori i Mbikëqyrjes Teknike, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 161, datë 12.03.2014
12.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Inspektimit Operacional, Drejtoria e Kontrollit të Shërbimit të Lundrimit Ajror	Përgjegjës Sektori Sektori i Mbikëqyrjes Operacionale, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror	Urdhër nr. 159, datë 12.03.2014
13.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Sigurisë dhe Koordinimit të Emergjencave, Drejtoria e Aeroporteve dhe Sigurisë	Përgjegjës Sektori Sektori i Mbikëqyrjes së Sigurisë në Transportin Ajror, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion	Urdhër nr. 144, datë 12.03.2014
14.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Mbikëqyrjes dhe Certifikimit të Aeroporteve, Drejtoria e Aeroporteve dhe Sigurisë	Përgjegjës Sektori Sektori i Parrezikshmërisë dhe Certifikimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve	Urdhër nr. 155, datë 12.03.2014,
15.	*****	Inspektor, Sektori i MCA, Drejtoria e Aeroporteve dhe Sigurisë	Inspektor, Sektori i Parrezikshmërisë dhe Certifikimit, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve	Urdhër nr. 156, datë 12.03.2014
16.	*****	Drejtor Drejtorja e Sigurisë Ajrore	Drejtor i Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Miratuar të Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 140, datë 12.03.2014

17.	*****	Inspektor, Sektori i Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Specialist IT, Sektori i Informacionit	Urdhër nr. 133, datë 12.03.2014
18.	*****	Përgjegjës i Sektorit Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Përgjegjës, Sektori i Operimeve dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 146, dt. 12.03.2014
19.	*****	Inspektor, Sektori Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Inspektor, Sektori i Operimeve dhe Certifikimit të OA, Drejtoria e Mbikëqyrjes së OA dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 147, dt. 12.03.2014
20.	*****	Inspektor, Sektori Operacional dhe Certifikimit të Operatorëve Ajror, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Inspektor, Sektori i Operimeve dhe Certifikimit të Mbikëqyrjes Aeromjekësore, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 153, dt. 12.03.2014
21.	*****	Përgjegjës Sektorit, Sektori i Licencimit të stafit dhe ekuipazhit dhe mbikëqyrjes aeromjekësore, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Inspektor, në Sektorin e Licencimit të Personelit dhe Mbikëqyrjes së OA dhe OM Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 152, dt. 12.03.2014
22.	*****	Inspektor, Sektori i Licencimit të stafit dhe ekuipazhit dhe mbikëqyrjes aeromjekësore, Drejtoria e Sigurisë Ajrore	Inspektor, në Sektorin e Licencimit të Personelit dhe Mbikëqyrjes Aeromjekësore, Drejtoria e Mbikëqyrjes së OA dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes	Urdhër nr. 151, dt. 12.03.2014
23.	*****	Drejtor, Drejtoria e Standardizimit teknik	Drejtor, Drejtoria e Standardizimit teknik	Urdhër nr. 136, datë 12.03.2014
24.	*****	Përgjegjës Sektorit, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, Drejtoria e Standardizimit teknik	Përgjegjës Sektorit, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Trafikun Ajror, Drejtoria e Standardizimit Teknik	Urdhër nr. 181, datë 12.03.2014
25.	*****	Inspektor, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Shërbimin e Lundrimit Ajror, Drejtoria e Standardizimit teknik	Inspektor, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Trafikun Ajror, Drejtoria e Standardizimit Teknik	Urdhër nr. 178, datë 12.03.2014
26.	*****	Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Urdhër nr. 139, datë 12.03.2014
27.	*****	Inspektor, Sektori i Mbikëqyrjes së Zbatimit të Marrëveshjeve të Shërbimeve Ajrore dhe Aktiviteteve Tregtare të Aviacionit në Aeroporte, Drejtoria e Zhv. Transportit Ajror	Inspektor, në Sektorin e Studimit dhe Implementimit të Politikës së Zhvillimit të Transportit Ajror dhe Infrastrukturrës, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Urdhër nr. 186, datë 12.03.2014
28.	*****	Inspektor, Sektori i Licencimit të Operatorëve Ajror dhe Mbikëqyrjes së Rregulloreve të Shërbimeve në Transportin Ajror, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Inspektor, Sektori i Mbikëqyrjes, Licencimit të Operatorëve Ajror dhe të Drejtave të Pasagjerëve, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Urdhër 185, datë 12.03.2014
29.	*****	Inspektor, Sektori i Licencimit të Operatorëve Ajror dhe Mbikëqyrjes së Rregulloreve të Shërbimeve në Transportin Ajror, Drejtoria e Zhvillimit të Transportit Ajror	Inspektor, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë në Aviacion dhe Aeroporte, Drejtoria e Standardizimit Teknik	Urdhër nr. 299, datë 30.04.2014
30.	*****	Drejtor, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Drejtor, Drejtoria Ekonomike	Urdhër nr. 130, datë 12.03.2014
31.	*****	Specialist, Sektori i Planifikimit Financiar, Statistikave, Tarifave dhe Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria Ekonomike	Urdhër nr. 168, datë 12.03.2014
32.	*****	Specialist, Sektori i Planifikimit Financiar, Statistikave, Tarifave dhe Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Planifikimit Drejtoria Ekonomike	Urdhër nr. 158/1, datë 05.04.2016

33.	*****	Specialist, Sektori i Planifikimit Financiar, Statistikave, Tarifave dhe Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria Ekonomike	Urdhër nr. 169, datë 12.03.2014
34.	*****	Specialist, Sektori i Planifikimit Financiar, Statistikave, Tarifave dhe Buxhetit, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Planifikimit Drejtoria Ekonomike	Urdhër nr. 170, datë 12.03.2014
35.	*****	Specialist, Sektori i Përfaqësimit Ligjor dhe Prokurimeve, Dr. e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Prokurimeve dhe Shërbimeve, Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve	Urdhër nr. 165, datë 12.03.2014
36.	*****	Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Dr. e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Specialist, Sektori i Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Administratës dhe Shërbimeve	Urdhër nr. 134, datë 12.03.2014
<b>Ulje në detyrë</b>				
37.	*****	Përgjegjës Sektori Sektori i Kontrollit të Cilësisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë	Inspektor, Sektori i Kontrollit të Cilësisë, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë	Urdhër nr. 174, datë 12.03.2014
38.	*****	Drejtor Drejtoria e Aeroporteve dhe Sigurisë	Përgjegjës Sektori, Sektori i Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Operatorëve Ajror dhe organizatave të miratuara të mirëmbajtjes	Urdhër nr. 451, datë 29.09.2016
39.	*****	Përgjegjës Sektori, Sektori i Përfaqësimit Ligjor dhe Prokurimeve, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	Inspektor, Sektori i Standardizimit Teknik për Sigurinë Ajrore dhe Trafikun Ajror, Drejtoria e Standardizimit Teknik	Urdhër nr. 166, datë 12.03.2014

Nëse e analizojmë rastin nga motivi i realizimit të këtyre veprimeve administrative, duke u nisur nga emërtesat aktuale të pozicionit të punës, rezulton se aktet e emërimit kanë përshtatur punonjësit e institucionit, në momentin e miratimit të strukturës, me pozicionet e punës të përcaktuara në strukturën e miratuar nëpërmjet vendimit nr. 100, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 791, datë 14.11.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të organikës, si dhe të nivelit të pagave të administratës së Autoritetit të Aviacionit Civil”, i cili ka hyrë në fuqi (pas botimit në fletoren zyrtare nr. 28/2014) në datën 11.03.2014, si dhe të akteve të tjera të Këshillit Drejtues të AAC, nëpërmjet të cilave janë shtuar pozicione pune në këtë strukturë. Konstatohet se në **34** raste, aktet e emërimit, kanë dalë në datën 12.03.2014 dhe në **5** raste, kanë dalë më pas.

Në lidhje me aspektin që po analizojmë, rezulton se nga ana e këtij institucioni, ende nuk është kryer procedura e implementimit të strukturës në përputhje me kërkesat e ligjit, edhe pse ajo është miratuar që në vitin 2014. Në këtë rast, ashtu si e analizuam edhe më sipër, emërimi i punonjësve të AAC në pozicionet aktuale, është realizuar nëpërmjet një akti emërimi, të nxjerrë nga Drejtori Ekzekutiv, ndërkohë që është Komisioni i Ristrukturimit, organi që ka të drejtën për të shqyrtuar mundësinë e sistemimit të punonjësve në pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil në një rast restrukturimi. Ky organ përcakton nëse punonjësi i plotëson kërkesat për tu emëruar në një pozicion pune dhe më tej, është njësia përgjegjëse, në këtë rast DAP, që merr vendimin përfundimtar për transferimin, ose përfundimin e marrëdhënies me shërbimin civil, pas propozimit të Komisionit të Ristrukturimit (*neni 50 i ligjit për nëpunësin civil*).



## **Konkluzion:**

Në rrethanat e parashtruara më sipër, të gjitha aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me këtë procedurë ligjore, të evidentuara në tabelën më sipër, në zbatim të nenit 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, duhet të konstatohen si akte absolutisht të pavlefshme nga titullari i institucionit dhe për të rregulluar ligjshmërinë në këtë moment të administrimit të shërbimit civil, institucioni i AAC, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të fillojnë menjëherë procedurën e riorganizimit të institucionit, në përputhje me kërkesat e ligjit. Departamenti i Administratës Publike, pas propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit, të nxjerrë aktet individuale të sistemimit të punonjësve në ato pozicione pune, ku ata i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta.

Ashtu si e kemi analizuar edhe më sipër, në këtë material, me qëllim që të mundësohet procesi i krahasimit të përshkrimit të punës dhe plotësimi i kërkesave ligjore të punonjësve aktual të AAC, si detyrim ligjor i Komisionit të Ristrukturimit, institucioni, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, duhet të punojë paralelisht me hartimin e përshkrimeve të punës dhe miratimin e tyre, në përputhje me ligjin.

Institucioni i mbikëqyrur, në observacionet e dërguara me shkresën nr. 600/1 prot., datë 16.03.2018, ka informuar se aktualisht është miratuar struktura e re e Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe për këtë arsye në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike është duke shqyrtuar mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë në përputhje me kërkesat e pozicioneve të shërbimit civil, sipas strukturës së re.

Në kushtet kur procedura e ristrukturimit është në zhvillim, Komisioneri çmon se, verifikimi i zbatimit të ligjit për shërbimin civil dhe kryerja e detyrave të përcaktuara në këtë rubrikë të raportit do të ndiqen më tej, nga grupi i punës i cili do të verifikojë zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit, pas përfundimit të afatit kohor që do të përcaktohet në këtë rast.

### ***V. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit***

#### ***a) Raste të lirit nga shërbimi civil nëpërmjet dorëheqjes.***

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, në institucionin e kontrolluar, lirimi nga shërbimi civil nëpërmjet dhënies së dorëheqjes nga detyra, i përcaktuar në nenin 66, germa "dh", të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është zbatuar në 2 raste dhe bëhet fjalë për punonjësit \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës në Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore” dhe \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore”. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për këta punonjës, është konstatuar përkatësisht me aktin nr. 67, datë 17.02.2016 dhe me aktin nr. 481, datë 01.11.2016, të njësisë së burimeve njerëzore.

Në këtë rast vlerësohet se njësia e burimeve njerëzore, ka vepruar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet dorëheqja si institut i ligjit.

Konkretisht, neni 64, i ligjit për nëpunësin civil, përcakton se: “Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\* , në momentin e lirimt nga shërbimi civil, nëpërmjet dorëheqjes, nuk e kishte përfutuar ende statusin e nëpunësit civil, pasi me aktin nr. 1606/6, datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike ishte deklaruar punonjës “Në pritje të plotësimit të kriterit të nivelit të diplomës”. Për këtë arsye, ai nuk përfiton nga e drejta e përcaktuar në dispozitën më sipër, pasi për procedurën e lëvizjes paralele është parashikuar që, kandidati që aplikon për këtë procedurë duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon dhe për procedurën e ngritjes në detyrë është parashikuar që kandidati duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar. Ndërsa punonjësja \*\*\*\*\* , në momentin e dorëheqjes kishte përfutuar statusin “nëpunës civil” e për këtë arsye, në bazë të dispozitave më sipër, ajo ka të drejtë të konkurrojë për procedurën e lëvizjes paralele dhe/apo ngritjes në detyrë, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil.

b) Raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimi civil për shkak të ligjit.

Për periudhën objekt mbikëqyrjeje, konstatohet se nga ana e institucionit është aplikuar në **1 rast**, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, të parashikuar nga shkronja “c”, e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Bëhet fjalë për punonjësën \*\*\*\*\* , “Inspektor në Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore”. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për këtë punonjës është konstatuar me aktin nr. 31 prot., datë 06.01.2017, të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit.

**Konstatim:**

Nga verifikimi i materialeve të administruara gjatë mbikëqyrjes, si dhe nga informacioni i marrë nga punonjësja e burimeve njerëzore, konstatohet se nëpunësi \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes”, vazhdon të ushtrojë detyrat e tij si nëpunës civil në këtë pozicion, megjithëse ka mbushur moshën për pension të plotë pleqërie (ky punonjës është i datëlindjes 10.10.1951).

Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore që rregullon përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil dhe për të rregulluar ligjshmërinë, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, duhet të konstatojë ekzistencën e shkaqeve të parashikuara në nenin 65, shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe për rregullimin e ligjshmërisë, të nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, për nëpunësin \*\*\*\*\* .

**Konkluzion:** Vlerësojmë se, përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për punonjësin Skënder Loli, është bërë për arsye të pranishme të shkaqeve të parashikuara nga neni 65, shkronja “c”, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në lidhje me punonjësin \*\*\*\*\*, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, sipas parashikimeve të nenit 65/c të ligjit për nëpunësin civil, të konstatojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit. Ky veprim, sipas kësaj dispozite, duhet të kryhet nga njësia e burimeve njerëzore, 5 ditë nga ndodhja apo njohja e shkaqeve të parashikuara në dispozitën në fjalë.

#### **VI. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës**

Për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues (*nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil*), që kishin një periudhë punësimi më pak se një vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve të ligjit. Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikua tërësia e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, për nëpunësit e deklaruar me status punësimi “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, periudhës së provës ka përfunduar përgjatë **vitit 2015**.

Rezulton se, gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të Kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s, konsiderohet i ndjekur me sukses, nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim. Nga verifikimi i vërtetimeve (*certifikatave*) të lëshuara nga ASPA rezulton se, në testimin përfundimtar nëpunësit janë vlerësuar me mbi 50 % të pikëve. Por në përfundim të periudhës së provës, për asnjë nga punonjësit e kësaj kategorie, nuk është finalizuar procesi i deklarimit të statusit.

**Konkluzion:** Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e punonjësve të deklaruar në periudhë prove (*për shkak të ligjit*), e për të cilët periudha e provës duhet të kishte mbaruar në vitin 2015, duhet të marrë masa për të finalizuar këtë proces, duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- Pas përfundimit të trajnimit dhe mbi bazën e vlerësimeve të rezultateve në punë, eprori direkt, pasi të marrë mendimin nga nëpunësi më i vjetër, duhet të finalizojë periudhën e provës për këta punonjës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të pikës 7, Kreu VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
- Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësve dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
- Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të pikës 13, Kreu VI, të aktit normativ të mësipërm, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit individual të deklaramit të statusit të punësimit për secilin nëpunës, brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni i AAC.

### ***VII. Procedura e transferimit të përkohshëm, në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil***

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, ndër të tjera, janë konstatuar disa parregullsi në lidhje me administrimin e shërbimit civil, për plotësimin e pozicioneve, të cilat krijohen të lira në mënyrë të përkohshme (*si në rastin e marrjes së lejes së lindjes, studimeve me afat të gjatë etj.*).

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, konkretisht sipas listë prezencës dhe listë pagesës së muajit Shtator 2017, konstatohet se në pozicionin e punës “*Specialist*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Administratës dhe Shërbimeve, është emëruar punonjësi \*\*\*\*\* , i cili është transferuar nga Aeroporti i Kukësit.

Për sa është arsyetuar në përmbajtje të këtij raporti, rezulton se ky punonjës nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil dhe emërimi i tij është bërë me akt emërimit të përkohshëm, për shkak të marrjes së lejes së lindjes nga punonjësja që ushtron detyrën në këtë pozicion.

Komisioneri, sjell në vëmendjen e titullarit të institucionit dhe të njësisë së burimeve njerëzore, se legjislacioni për shërbimin civil dhe aktet normative të dala në zbatim të tij, përcaktojnë qartë procedurën ligjore që duhet të ndiqet nga institucionet, për plotësimin e pozicioneve të cilat në kuptim të ligjit, krijohen të lira në mënyrë të përkohshme.

Në këto raste, institucioni për interes të tij, në kuadër të mbarëvajtjes dhe kryerjes së funksioneve dhe detyrave, në zbatim të nenit 48, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, mund t’i plotësojë këto pozicione nëpërmjet transferimit të përkohshëm. Në kuptim të kësaj dispozite, nëpërmjet transferimit të përkohshëm, institucioni mund të transferojë në këto pozicione nëpunës civil të të njëjtit institucion, nga një institucion në varësi të tij, ose nga një institucion tjetër i shërbimit civil.

Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, përcakton procedurën përkatëse që duhet të zbatohet në këtë rast. Në kuptim të Kreut I, pika 4, të këtij akti normativ, institucioni që ka interes duhet të paraqesë një kërkesë, e cila duhet të miratohet nga institucioni, ku ushtron detyrën nëpunësi i cili do të transferohet në pozicionin e lirë të krijuar në mënyrë të përkohshme.

Ky transferim, duhet të miratohet nga njësi përgjegjëse, DAP, e cila analizon plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozicionit të punës si dhe të kushteve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe në përfundim, njofton nëpunësin që do të transferohet, duke përcaktuar në këtë akt kohëzgjatjen e transferimit, e cila në zbatim të nenit 48, pika 1, të ligji të sipërcituar, duhet të jetë deri në 6 muaj gjatë 2 viteve. Në këtë rast, nuk është respektuar kjo procedurë.

### **Konkluzion:**

Procedura e emërimit (*transferimit*) të nëpunësit \*\*\*\*\*, vjen në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në nenin 48, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt. Për më tepër, konstatohet se punonjësi \*\*\*\*\*, nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil dhe si rrjedhim, ai nuk mund të ushtrojë detyra në pozicione të shërbimit civil.

Mosrespektimi i procedurës së sipërcituar, në zbatim të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përcakton pavlefshmërinë absolute të akteve që materializojnë këtë proces dhe, si të tilla, këto akte nuk sjellin pasoja juridike.

Në këtë rast, nëpërmjet aktit administrativ nr. 571, datë 21.11.2017, ku parashikohet kthimi i punonjësit në fjalë në pozicionin e mëparshëm të punës, njësi e burimeve njerëzore ka informuar grupin e punës, se kjo gjendje paligjshmërie është rregulluar gjatë procesit të mbikëqyrjes, është evidentuar në këtë material, me qëllim që në të ardhmen, në një situatë të tillë, institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të kryejë të gjitha veprimet administrative, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të tij.

### **VIII. Disa mangësi të evidentuara në lidhje me menaxhimin e njësisë së burimeve njerëzore dhe niveli i bashkëpunimit me Departamentin e Administratës Publike.**

Njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si në ato qendrore dhe në institucionet e vartësisë, janë mekanizma që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, rol i cili buron nga përcaktimet specifike të nenit 10, të ligjit për nëpunësin civil, e vijon me kompetencat ligjore të përcaktuara shprehimisht gjatë zhvillimit të procedurave ligjore që parashikojnë dispozitat në vijim të këtij ligji.

Pozicionimi në këtë mënyrë i këtyre njësive, në institucionet e vartësisë, i vendos ato për krahas njësive të burimeve njerëzore të ministrisë nga varet institucioni, si dhe Departamentit të Administratës Publike, në procesin e zbatimit të reformave strukturore dhe funksionale, të ndërmarra nga qeveria në kuadër të reformës së përgjithshme në shërbimin civil.

Gjatë ushtrimit të kompetencës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, kjo njësi bashkëvepron dhe bashkërendon punët me Departamentin e Administratës Publike, si dhe me njësitë e tjera pjesë të strukturës së institucionit me qëllim që të sigurohet zbatimi i parimeve të sanksionuara në ligjin e shërbimit civil dhe të respektohen procedurat ligjore për çdo institut të tij,

ndër të cilat, hartimi i planit të nevojave për rekrutim e trajnim të stafit, hartimi i përshkrimeve të punës, vlerësimet e performancës, evidentimin e karrierës së personelit pjesë përbërëse e institucionit, etj.

Në analizë të strukturës organizative të Autoritetit të Aviacionit Civil, duke vlerësuar rolin e rëndësishëm që ka ky institucion, për shkak të fushës specifike ku ai vepron, rezulton se në përbërjen e strukturës së tij, është krijuar njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore, me emërtesën, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Konstatohet se gjatë periudhës 2014-2017, ky sektor është i organizuar fillimisht, me 1 pozicion pune "*Përgjegjës Sektori*" dhe 2 pozicione pune "*Specialist*", të cilët kryejnë detyrat e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe më tej, në vitin 2017, rezulton se është shtuar edhe një pozicion pune "*Specialist*", në këtë sektor.

Duke u nisur nga konstatimet e grupit të mbikëqyrjes, rezulton se në aspekte të rëndësishme të administrimit të shërbimit civil, njësi e burimeve njerëzore nuk i ka zbatuar detyrimet ligjore, që i ngarkon ligji nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Ndër të tjera, ajo ç'ka vlen të theksohet më shumë, është fakti se, megjithëse DAP ka konstatuar pavlefshmërinë absolute, për një numër të konsiderueshëm të akteve të emërimit, për disa raste të përmendura në përmbajtjen e raportit, përsëri në këtë institucion ka vazhduar e njëjta situatë në kundërshtim me ligjin, që përfaqëson emërimet të punonjësve nga titullari i institucionit, duke mos zbatuar procedurat e nenit 23, të ligjit në fjalë.

Nga gjithë dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, nuk është evidentuar asnjë material shkresor sinjalizues nga njësi e burimeve njerëzore në institucion, për të informuar DAP, titullarin e institucionit, apo qoftë edhe bordin drejtues të institucionit, në lidhje me situatën e paligjshme, me qëllim që të merreshin masat e nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë.

Nga informacioni i administruar në subjekt, rezulton se, duke filluar nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, që shënon përfshirjen e institucionit në sistemin e shërbimit civil, në drejtorinë që menaxhon burimet njerëzore, kanë kryer funksionet në përbërje të saj, sipas periudhës respektive që do të detajohet më poshtë, këta punonjës:

- ✓ Në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë, punonjësi \*\*\*\*\* dhe në pozicionin e Specialistit, punonjëset Danida Vaso, Specialiste e burimeve njerëzore, (*periudha 2010 – 9 tetor 2015*) e zëvendësuar nga punonjësja \*\*\*\*\* , me kontratë pune (*periudha Tetor 2015 – Tetor 2016*) dhe punonjësja \*\*\*\*\* , Specialiste arkiv/protokoll (*në periudhën 2010, e në vijim*).
- ✓ Duke filluar nga muaji prill 2017, e në vijim, në këtë njësi është shtuar edhe një pozicion pune në sektorin e burimeve njerëzore dhe aktualisht Drejtoria që mbulon këtë sektor, përbëhet nga punonjësit \*\*\*\*\* , Drejtor Drejtorie; \*\*\*\*\* , Specialiste, e punësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil; \*\*\*\*\* , Specialist, i emëruar në datën 20.3.2017, i cili vazhdon të punojë, në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet emërimit të

përkohshëm me kontratë individuale pune dhe \*\*\*\*\*\*, Specialiste, emëruar në datën 20.4.2017, në kundërshtim me ligjin me kontratë individuale pune.

Ashtu siç e theksuam më sipër, në ndryshimet e reja strukturore të institucionit, vihet re se sektori i burimeve njerëzore është mbështetur edhe me një pozicion tjetër shtesë, ç`ka tregon edhe njëherë për rëndësinë që ka ky sektor në Institucion e AAC-së. Por, nga ana tjetër, duke analizuar veprimtarinë e kësaj njësie, vlerësojmë se ajo nuk i është përgjigjur nevojave të institucionit dhe kërkesave ligjore, ç`ka evidentohet edhe në faktin se, emërimet në kundërshtim me ligjin, në dy raste, konstatohen edhe në përbërjen e saj.

Në këtë moment, duke mos anashkuar përgjegjësinë e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të evidentojmë edhe faktin se, niveli i përgjegjësisë për shkëlqjen e ligjit në administrimin e shërbimit civil, është më i lartë tek veprimet e titullarit të institucionit, i cili ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin dhe ka kryer emërimet në pozicione të shërbimit civil, nëpërmjet akteve të nxjerra prej tij, në kapërcim të kompetencave ligjore, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 23, të ligjit për nëpunësin civil edhe pse në përmbajtjen e tij, përcaktohet në mënyrë të shprehur se, emërimet e kryera në kundërshtim me këtë ligj, janë veprime juridike absolutisht të pavlefshme.

**Konkluzion:** Për të gjitha sa u argumentuan më sipër, vlerësohet se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, duhet të kryhet një analizë e plotë e veprimtarisë së aktorëve të përcaktuar nga ligji për administrimin e burimeve njerëzore në institucion dhe njësisë që mbulon menaxhimin e burimeve njerëzore, të cilët në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë institucion, duhet të përcaktojnë përgjegjësitë konkrete për situatën kaotike të krijuar në menaxhimin e burimeve njerëzore Autoritetit të Aviacionit Civil.

\*  
\*       \*  
\*

Këto ish-in rethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes tematike në institucionin e Autoritetit të Aviacionit Civil, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, duke filluar nga shtrirja e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar e në vijim.

Njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**